VENDIM
Nr. 43, datë 11.9.2012

PËR MIRATIMIN E HARTËS RAJONALE TË NDIHMËS SHTETËRORE

Komisioni i Ndihmës Shtetërore i përbërë nga z. Edmond Haxhinasto, kryetar, z. Zef Preçi, nënkryetar dhe znj. Mimoza Dhëmbi, z. Dritan Hylli, anëtar mori në shqyrtim dokumentacionin për miratimin e hartës rajonale të ndihmës shtetërore.

Objekti: Përgatitja e hartës rajonale për përcaktimin e zonave që mund të përfitojnë ndihmë shtetërore rajonale me një intensitet më të lartë për të nxitur zhvillimin ekonomik të zonave me standard të ulët jetese ose me nivel të lartë të papunësisë.

Baza ligjore: Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar dhe rregullorja "Për kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës rajonale", miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 28.12.2005, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 102, datë 9.1.2006.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe gjithë dokumentacionin mbështetës

VËREN SE:

1. Në bazë të nenit 71 (7) (paragrafi 2) i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare", Shqipëria angazhohet që brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e MSA-së, t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Europiane, shifrat e PBB-së[1] së saj për frymë, të harmonizuar me nivelin e NUTS II[2].

Komisioni i Ndihmës Shtetërore dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane do të vlerësojnë bashkërisht kriteret e pranueshmërisë së rajoneve të Shqipërisë, si dhe intensitetin maksimal të ndihmës në lidhje me to në mënyrë që të përgatisin hartën rajonale të ndihmës mbi bazën e direktivave përkatëse të komunitetit.

2. Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka vlerësuar pranueshmërinë e rajoneve në mënyrë që të përgatisë hartën rajonale të ndihmës në bazë të udhëzimit të BE-së për ndihmën rajonale kombëtare për periudhën 2007-2013[3] dhe rregullores "Për kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës rajonale", miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 28.12.2005.

3. Instituti i Statistikës (INSTAT) në bashkëpunim me EUROSTAT bëri ndarjen e Republikës së Shqipërisë në tri rajone: a) Durrës dhe Veriu; b) në Tiranë dhe Elbasan; c) Jugu[4].

4. INSTAT ka publikuar rezultatet e PBB-së për vitin 2009 për Republikën e Shqipërisë në nivel rajonal statistikor 1, 2 dhe 3 të harmonizuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) në zbatim të MSA-së. Sipas të dhënave të INSTAT-it, PBB-së e Republikës së Shqipërisë, e shprehur në PPS për vitin 2009 është 20.813 PPS ose 27.6% e mesatares së Bashkimit Europian (BE 27=100). Në nivelin statistikor 2, në Rajonin Qendror, PBB për frymë e shprehur në PPS ishte 35.8%, ndërsa në rajonet e veriut dhe të jugut ishte respektivisht 22.9% dhe 23.1%.

5. Shqipëria përbëhet nga tri rajone të nivelit NUTS II, nga të cilat asnjëri nuk ka një PBB/PPS[5] për frymë që tejkalon 75% të mesatares së Komunitetit, sipas të dhënave statistikore në dispozicion për vitet 2007-2013. Shqipëria do të konsiderohet si një zonë e njëjtë me ato fusha të Komunitetit të

[1] PBB (produkti i brendshëm bruto).
[2] Numri i popullsisë për çdo njësi joadministrative në nivel të nomenklaturës së njësive territoriale për statistikat NUTS II është i harmonizuar me intervalin e vendosur nga Komisioni Europian nga 800 mijë banorë në një maksimum prej 3 milionë banorësh.
[3] OJ C 54, 4 mars 2006, paragrafi 44, 45 dhe 49.
[4] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 15.12.2010 "Për zbatimin e nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II", sipas nomenklaturës së njësive territoriale për statistikat (NUTS) të Bashkimit Europian"".
[5] PPS (Purchaser Power Standard) - Monedhë e përbashkët "artificiale", e cila barazon fuqinë.

përshkruara në nenin 107 (3) (a) "Traktati mbi funksionimin e Bashkimit Europian".[6] Në rajonet e nivelit NUTS II, intensiteti i ndihmës rajonale nuk duhet të kalojë 50% të ENG-së[7], të cilit mund t'i shtohet edhe 20% kur përfituesi është ndërmarrje e vogël (ose 10% në rastin e ndërmarrjeve të mesme).

6. Intensiteti i ndihmës rajonale për të tri rajonet e nivelit NUTS II në Shqipëri (Durrës dhe Veriu, Tirana dhe Elbasani, Jugu) do të jetë i njëjtë sepse nivelet PBB/PPS për frymë së secilës prej tyre janë nën nivelin e mesatares së Komuntetit Europian.

7. Intensitetet maksimale të ndihmës së zbatueshme në secilin prej rajoneve të mësipërme, të vlerësuara nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga direktivat e Komunitetit për ndihmën kombëtare rajonale dhe nga legjislacioni për ndihmën shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore bazuar në nenin 70, paragrafit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asoccimit, të ratifikuar nga ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe Shteteve të tyre anëtare", nenin 17 shkronja "d" të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar dhe nenit 5, paragrafët 2 dhe 3 të rregullores "Për kushte dhe procedurat për dhënien e ndihmës rajonale", miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Gjithë territori i Republikës së Shqipërisë do të konsiderohet si një zonë e njëjtë me zonat e përshkruara në nenin 107 (3) (a) "Traktati mbi funksionimin e Bashkimit Europian".

2. Intensiteti i ndihmës rajonale i aplikueshëm për gjithë territorin e Shqipërisë nuk duhet të kalojë 50% të ekuivalentit bruto të grantit.

3. Kufijtë e përcaktuar në pikën 2 mund të rriten me 20%, kur përfituesi i ndihmës shtetërore është një ndërmarrje e vogël apo 10% në rastin e një ndërmarrjeje të mesme.

4. Pjesë e këtij vendimi është dhe harta rajonale e ndihmës shtetërore (aneksi 1).

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Edmond Haxhinasto

[6] Ish-neni 87 (3) (a) i Traktatit Themelues të Komunitetit Europian.
[7] ENG (Ekuivalent neto i grantit)